

Prof. Dr. Hajredin Kuci

Zëvendëskryeministër dhe ministër i Drejtësisë

PRIORITETET E MINISTRISË SË DREJTËSISË:

Ministria e Drejtësisë ne mandatin 2011-2014, do të ketë këtë koncept pune mbi bazën e 6 (gjashtë) prioriteteve -- të listuara si më poshtë:

1. Koordinimi i Sistemit të Drejtësisë:

Ministria e Drejtësisë do të koordinojë punët për një bashkëpunim më të mirë me Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), Gjykatën Supreme (GJS) dhe Institucionet ndërkombëtare të drejtësisë në Kosovë (EULEX, etj.).

Eshtë themeluar Këshilli Konsultativ për Reforma në Drejtësi (prill 2011), në të cilin Këshill pritet të marrin pjesë bartësit e institucioneve të drejtësisë: si nga Kuvendi i Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Gjykata Kushtetuese, Gjykata Supreme, ekspertë juridikë nga teoria dhe praktika juridike dhe njerëz me autoritet nga shoqëria civile, institucionet akademike dhe partitë politike. Ky Këshill do të udhëhiqet nga një person i shoqërisë civile, që simbolizon drejtësinë në vend.

Eshtë themeluar Instituti për Hulumtimin e Krimeve të Luftës (prill 2011), i cili Institut si institucion publik hulumtues me qëllim të koordinimit, përcjelljes dhe hulumtimit të krimeve të luftës kundër paqes, krimet e gjenocidit dhe të shkeljeve tjera të rënda të drejtës ndërkombëtare të kryera në Kosovë.

Do të themelohet Akademia gjyqësore dhe prokuroriale e Kosovës, e cila Akademi do t'i trajnojë dhe udhëheq juristët e Kosovës drejt rrugëtimit të tyre profesional për t'u bërë gjyqtarë dhe prokurorë të ardhshëm në Republikën e Kosovës.

Do të propozohen takime të rregullta në mes të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Gjykatës Supreme, si dhe një herë në muaj do të mbahet konferencë e përbashkët për media.

Do të zhvillohet bashkëpunim i ngushtë me Oden e Avokatëve të Kosovës. Ministria e Drejtësisë do të vazhdojë trajtimin e kërkesave ligjore të bashkëpunimit ndërkombëtar, në mënyrë adekuate dhe në kohën e duhur, duke siguruar lehtësimin e EULEX-it, kur është fjala për vende që nuk e kanë njohur Kosovën (në veçanti shtetet anëtare të BE dhe vendet e rajonit), si dhe do të bëhet

nënshkrimi i disa marrëveshjeve për ndihmë juridike ndërkombëtare, me disa shtete të rajonit dhe më gjerë.

2. Legjislacioni:

Ka filluar rishikimi i planit të punës për vitin 2011, me strategjinë legjislativë për këtë vit dhe me strategjinë e Ministrisë së Drejtësisë 2010-2015, ku do të bëhet harmonizimi i legjislacionit me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me *'Acquis communautaire'* (kompatibiliteti me legjislacionin e Bashkimit Evropian), që do të bëhet nga MD me ndihmën e eksperteve vendore dhe ndërkombëtare. Do të punohet në implementimin e ligjeve në veçanti: Ligjin për Gjykatën, *Ligjin për Këshill Gjyqësor të Kosovës, Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Ligjin për Prokurorin e Shtetit;*

Ministria e Drejtësisë do t'i jep përparësi përgatitjes së këtyre ligjeve:

- *Ligji për Mbrojtjen e Dëshmitareve;*
- *Ligji për Konfiskimin e Pasurisë të fituar me vepër penale (Ligji anti-mafia);*
- *Kodin Penal të Kosovës;*
- *Kodin e Procedurës Penale;*
- *Ligjin për Detyrimet;*
- *Amandamentimin e Ligjit për Noterinë (është amandamentuar në muajin prill 2011 nga Kuvendi i Kosovës);*
- *Ligjin për përmbarim;*
- *Ligji për Përgjegjësinë penale të personave juridik, etj.*

3. Funkcionalizimi dhe strukturimi i Gjykatave dhe Prokurorive:

Ministria e Drejtësisë në bazë të kompetencave ligjore që ka, do të përkujdeset për implementimin e plotë të Ligjit për Gjykatat pas riorganizimit të tyre, pasi parashihet shndërrimi i Gjykatave aktuale komunale në Gjykata Themelore, një të Apelit dhe Gjykatës Supreme. Do të mbështetet rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend, në përputhje me nevojat dhe standardet ndërkombëtare.

Ministria e Drejtësisë dhe autoritetet relevante në Kosovë, do të mundohen të sigurojnë burimet e nevojshme buxhetore për KGJK-në dhe KPK-në, që të vazhdojë procesi i emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në bazë të vendeve të lira në dispozicion, duke siguruar përfaqësimin e komuniteteve jo-shumicë, siç parashikohet me ligjet përkatëse.

Do të mbështetet krijimi i strukturës së re të sistemit gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë, sipas ligjeve që janë në fuqi nga janari i vitit 2011.

Stafi në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, do të përzgjidhet nga vetë këto institucione dhe Ministria e Drejtësisë më nuk do të ndërhyjë në këtë proces.

Do të ndihmohet Instituti Gjyqësor i Kosovës, në rritjen e kapaciteteve të veta për përgatitjen e kandidatëve për prokurorë dhe gjyqtarë dhe atë së paku për 50 % me shumë se sa përgatisnin tani, deri në plotësimin e kapaciteteve të duhura për përgatitjen e kandidatëve për gjyqtarët dhe prokurorët e vendit.

Ministria e Drejtësisë do të themelojë edhe disa institucione tjera të cilat në masë të madhe do të lehtësojnë punën e gjyqësorit.

Do të funksionalizohet sistemi i noterisë për herë të parë në Kosovë.

Do të funksionalizohet sistemi i ndërmjetësimit.

Do rritet efikasiteti sa i takon procedurave për dhënien e provimit të Jurisprudencës.

Ministria e Drejtësisë do të funksionalizojë me kapacitete të plota Agjencionin për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar ose Konfiskuar, duke e organizuar këtë Agjenci dhe duke bashkëpunuar ngushtë me Gjykatat dhe Policinë e Kosovës.

Do të rrisë efikasitetin e Shërbimit Korrektues dhe Shërbimit Sprovues të Kosovës, duke rritur disiplinën në punë, por edhe duke respektuar të drejtat e të burgosurve, për çka do të ftohën organizatat e shoqërisë civile të monitorojnë me punën e Shërbimit Korrektues të Kosovës. Po ashtu do të themelohet Agjencioni për Inspektimin e Shërbimit Korrektues të Kosove.

Departamentin e Mjekësisë Ligjore, do ta bëjë më funksional me pajisje dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, do të ndihmohet në ngritjen kadrovike të këtij departamenti si dhe në bashkëpunim me Komision Qeveritar të të Pagjeturve, të ketë prioritete në identifikimin e mbetjeve mortore.

4. Veriu (kjo nënkupton vendosjen nënë juridiksion të plote të Gjykatave dhe Prokurorive që gjenden në Veri:

Ministria e Drejtësisë do të përkujdeset për zbatim të plote dhe të njëjlojtë të ligjeve në tërë territorin e Kosovës.

Rifunksionalizimi i gjykatave në Mitrovicën e Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, është prioritet i Ministrisë së Drejtësisë, ku për këtë do të ketë një koordinim dhe bashkëpunim të mirë me EULEX-in, për funksionalizimin e Gjykatave dhe zbatimin e ligjit në këtë pjesë të Kosovës.

5. Exit Strategy for EULEX – Strategjia dalëse për EULEX-in (kalimin/bartjen e kompetencave në fushën e Drejtësisë nga EULEX-i tek institucionet vendore):

Bashkëpunimi me EULEX, Komisionin Evropian, ICO dhe USAID dhe mekanizmat tjerë ndërkombëtar do të jetë i plotë si partneritet, por gjithnjë duke marrë përgjegjësitë që na takojnë me Ligje dhe Kushtetutë.

Do të iniciohet procesi i transferimit të kompetencave në fushën e sundimit të ligjit nga EULEX-i tek institucionet vendore.

6. Raporti i Progresit i Komisionit Evropian

Ministria e Drejtësisë do t'i kushtojë kujdes të veçantë Raportit vjetor të Progresit të Komisionit Evropian.

Raporti i Progresit do të jetë udhërrëfyes i punës të secilit punëtor në Ministrinë e Drejtësisë.

Më një punë të përbashkët të stafit politik dhe atij civil, pra të Këshilltarëve, Departamenteve, Agjencioneve, Zyrave etj., të Ministrisë së Drejtësisë, do të punohet më përkushtim në përmbushjen e të gjeturave dhe rekomandimeve që dalin nga Raporti i Progresit për sa i takon Ministrisë së Drejtësisë.

**Prishtinë,
Prill 2011**